

## *Rregullore e Brendshme e Rrjetit Anna Lindh Shqipëri*

Rregullorja e brendshme e rrjetit Anna Lindh Shqipëri, *hartuar sipas udhëzimeve dhe modelit të paraqitur nga Fondacioni Anna Lindh*, ka për qëllim të *qartësojë rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të rrjetit dhe Drejtuesit të Rrjetit, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të tij.*

### **Neni I. Shkurtime dhe sqarime**

1. Rrjeti, këtej e tutje do të përdoret si shkurtime për Rrjetin Kombëtar Anna Lindh Shqipëri
2. Institucioni në ngarkim të koordinimit të Rrjeti Kombëtar Anna Lindh Shqipëri këtej e tutje quhet Drejtuesi i Rrjetit (DiR)
3. Personi në ngarkim të koordinimit të Rrjeti Kombëtar Anna Lindh Shqipëri këtej e tutje quhet Koordinator Kombëtar (KK).
4. Fondacioni Anna Lindh quhet shkurtimeisht Fondacioni ose ALF.

### **Neni II. Vizioni dhe misioni i Rrjeti Kombëtar Anna Lindh Shqipëri**

Rrjeti Kombëtar do të shndërrohet në rrjetin më të madh të organizatave të angazhuara në promovimin e dialogut ndërkulturor në Shqipëri.

1. Rjeti Kombëtar *promovon* Partneritetin Euro-Mesdhetar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Rrjeti Kombëtar do të *kontribuojë në zhvillimin e prioriteteve dhe programeve të Fondacionit*, duke ndarë të njëjtin vizion mes Rrjeteve të tjera Kombëtare dhe Zyrës Qendrore të ALF-së.
3. Rrjeti *promovon aktivitete* të përbashkëta në nivel kombëtar midis anëtarëve të Rrjetit, në përputhje me objektivat e Fondacionit.

### **Neni III. Drejtuesi i Rrjetit**

Fondacioni Anna Lindh është organizatë ndër-qeveritare. Drejtuesi i Rrjetit në Shqipëri emërohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, me të paktën një mandat tri-vjeçar dhe me kohëzgjatje të pacaktuar, përveçse nëse i emëruari vendos të heqë dorë nga drejtimi. Në Shkurt 2020, Drejtuesi i Rrjetit është emëruar Instituti Shqiptar i Medias.

#### ***Rolet dhe funksioni që kryen DiR janë si vijon:***

1. Vepron si përfaqësuesi kombëtar i Fondacionit në Shqipëri
2. Menaxhon veprimtarinë e Rrjetit Kombëtar

3. Promovon imazhin e Fondacionit si institucion Euro-Mesdhetar i krijuar për forcimin e dimensionit rajonal të Partneritetit Euro-Mesdhetar - Bashkimi për Mesdheun në çështjet sociale, kulturore dhe njerëzore (*Kapitulli i Tretë i Deklaratës së Barcelonës*).
4. Menaxhon anëtarësimin në rrjet; Identifikon aktorët e mundshëm aktivë të shoqërisë civile në vend, të cilët mund të anëtarësohen në rrjet.
5. Kontribuon në konsultimin dhe zhvillimin e programeve vjetore dhe tre-vjeçare të ALF-së. DiR do të marrë në konsideratë interesat e Rrjetit të tij Kombëtar.
6. Mbështet dhe mbikëqyr trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për Rrjetin Kombëtar;
7. Vepron si një agjent i marrëdhënieve me publikun, harton dhe publikon materiale informuese për shpërndarje dhe kontribuon në faqen e ALF-së; faqen e Rrjetit Kombëtar (*kur aplikohet*) dhe Media Sociale;
8. Informon Anëtarët e Rrjetit për shpalljen e thirrjeve për propozime, bashkë-organizimin e ngjarjeve, modalitetet dhe procedurat se si të aplikojnë;
9. Koordinon komunikimin dhe vizibilitetin e Rrjetit ALF (*p.sh. duke kontribuar në përmbajtjen e faqeve të rrjetit në faqen e internetit të ALF dhe portalet e mediave sociale*);
10. Lehtëson kërkimin për partnerë projektit për anëtarët (*brenda ose midis rrjeteve të tjera*).
11. Merr pjesë në ngjarje të ndryshme të ALF (*p.sh. takimi vjetor i Kryetarëve të Rrjetit*) sa herë që ftohet. Koordinatori duhet të sigurojë që anëtarët e rrjetit të jenë të informuar për ngjarjet e ndryshme në të cilat ai/ajo po merr pjesë dhe të mbledhë kontributin e anëtarëve nëse kjo gjë është e nevojshme;
12. Koordinohet me selinë e ALF-së rregullisht për përditësimet dhe shkëmbimin e informacionit.
13. Ndan me anëtarët e Rrjetit raportin vjetor, me qëllim që të informojë anëtarët për veprimtarinë 1-vjeçare të Rrjetit Kombëtar dhe të Fondacionit Anna Lindh.

#### **Neni IV. Anëtarësimi në Rrjetin Kombëtar**

##### **1. Kriteret për anëtarësim:**

- Rrjeti Kombëtar është i hapur për *institucione, organizata dhe partnerë të tjerë* që u përmbahen parimeve dhe misionit të Fondacionit Anna Lindh dhe që punojnë në bazë të vlerave demokratike, siç përcaktohet në Nenin II.1 të Statutit të ALF-së.
- Anëtarët e tij mund t'i përkasin kategorive të mëposhtme: *OJQ-ve; Institucioneve publike, përfshirë autoritetet lokale dhe rajonale; Fondacione publike dhe private "jofitimprurëse"; partnerëve të tjerë «fitimprurës»* që promovojnë aktivitete «jofitimprurëse» dhe politika të përgjegjësisë sociale të korporatave.
- Rrjeti Kombëtar pasqyron shumëllojshmërinë e shoqërisë civile dhe është i ftuar të asociojë partnerë të përfshirë në fushat tematike të ALF-së siç përcaktohet më poshtë: marrëdhëniet ndërkombëtare/kulturore, trashëgimia, feja, universitetet dhe institutet

kërkimore, të Drejtat e Njeriut, demokracia dhe zhvillimi i komunitetit, artet, të Rinjtë, arsimit, barazia gjinore, mjedisi/zhvillimi i qendrueshëm dhe media.

- Drejtuesi i Rrjetit ka të **drejtën e refuzimit të aplikimeve për anëtarësim**. Pas konsultimit me anëtarët e Rrjetit Kombëtar, Koordinatorin mund të mos të pranojë aplikantët që nuk janë në përputhje me misionin dhe vlerat e Fondacionit Anna Lindh.
- Drejtuesi i Rrjetit ka të **drejtë të kufizojë përkohësisht madhësinë maksimale** të Rrjetit në mënyrë që ta konsolidojë atë dhe të përmirësojë performancën e tij.
- **Anëtarësimi** në rrjetin shqiptar është **pa pagesë dhe i hapur për anëtarë të rinj**, veprimtaria e të cilëve përputhet me *misionin dhe vlerat e Fondacionit Anna Lindh*. Të interesuarit mund të aplikojë për t'u anëtarësuar përmes faqes së internetit të Fondacionit: [www.annalindhfoundation.org](http://www.annalindhfoundation.org)

## 2. *Kriteret për përjashtim të anëtarëve nga rrjeti:*

Me qëllim ruajtjen e efektivitetit të Rrjetit dhe pasurimin e tij me anëtarë aktive dhe kontribues, **Drejtuesi i Rrjetit ka përgjegjësinë të rishikojë anëtarësimet.**

Anëtarësimet **rishikohen për ata anëtarë që janë pasivë** në komunikimin me Koordinatorin Kombëtar, po ashtu edhe në pjesëmarrje në aktivitetet e Fondacionit (p.sh nuk iu përgjigjen e-maileve, telefonatave; nuk marrin pjesë në takimet fizike dhe/ose online që DiR organizon; nuk marrin pjesë dy vite rresht në takimin Vjetor të Rrjetit, etj.)

**Rishikimi i anëtarësisë përfshin tërheqjen e vëmendjes** së anëtarit pasiv nëpërmjet një komunikimi formal (e-mail) dhe në rast mungese reagimi prej tij, Drejtuesi i Rrjetit mund të marrë masën e përjashtimit nga Rrjeti.

## 3. *Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Rrjetit Kombëtar*

- Pjesëmarrja në thirrjet për propozime që publikon Fondacioni, duke ndjekur kriteret e përfshira në thirrjen për propozime;
- Pjesëmarrja në trajnimet, seminarët, konferencat, programet etj. që organizon Fondacioni dhe/ose rrjete të tjera Kombëtare
- Formësimi aktiv i Rrjetit Kombëtar përmes marrjes së vendimeve të përbashkëta për aktivitetet, përparësitë dhe veprimet kryesore të Rrjetit;
- Shprehja e opinionëve dhe paraqitja e propozimeve për Koordinatorin Kombëtar dhe nëpërmjet tij, Sekretariatit të ALF-së.
- Shkëmbimi i përvojave, opinionëve dhe nxitja e bashkëpunimit me Anëtarët e tjerë të Rrjetit si dhe Rrjetet e tjera Kombëtare të Fondacionit.

- Të ndajnë informacionin që marrin nga Drejtuesi i Rrjetit me punonjësit dhe/ose target grupin përfitues, në varësi të informacionit që është dërguar.
- Të raportojnë tek Drejtuesi i Rrjetit për raste të organizatave anëtare që shkelin parimet dhe vlerat e Fondacionit dhe të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, të shprehin qëndrimin e tyre lidhur me masën që do të merret përkundrejt anëtarit shkelës.
- Të ndajnë informacione, mundësi, thirrje që lidhen me dialogun ndërkulturor në Shqipëri dhe më gjerë, të cilat i ofrojnë ata vetë, ose që kanë dijeni se i ofrojnë palë të tjera; si edhe të organizojnë aktivitete të përbashkëta me anëtarët e tjerë të rrjetit në kuadër të promovimit të dialogut ndërkulturor.

Të përditësojnë në kohë Drejtuesin e Rrjetit për ndryshime në të dhënat e organizatës, ku përfshihet ndryshimi i kontakteve, adresës, personave të kontaktit dhe çdo informacioni tjetër që është identifikues për anëtarin.

#### **Neni V. Struktura e Rrjetit dhe qeverisja**

Rrjeti Kombëtar aktual përbëhet nga 50 organizata. Për qeverisjen dhe menaxhimin e tij ngarkohet Drejtuesi i Rrjetit.

Drejtuesi i Rrjetit është përfaqësuesi formal i të gjithë rrjetit në komunikimet me palë të tjera, përfshirë edhe ALF-në.

Rrjeti Kombëtar mbledhet 1-herë në vit, me nismën e Drejtuesit të Rrjetit dhe kostot për këtë takim mbulohen nga buxheti që ALF-ja ofron nëpërmjet skemës së Mbështetjes për Menaxhim.

#### **Neni VI: Parimet Etike**

Si anëtar i Rrjetit Kombëtar Shqiptar ALF, ju zotoheni të veproni ndaj anëtarëve të tjerë në një mënyrë të ndershme dhe të respektueshme. Ne vlerësojmë shumëllojshmërinë e rrjetit tonë dhe përpiqemi që të shfrytëzojmë potencialin e tij për të shkëmbyer përvoja, njohuri dhe aftësi të ndryshme. Gjithashtu, si anëtar, ju duhet të jeni të gatshëm të komunikoni me çdo anëtar tjetër në Rrjetin Kombëtar ALF, rrjete të tjera ndërkombëtare dhe nuk përjashtoni një person bazuar në përkatësinë e tij/saj kombëtare/fetare/etnike/seksuale, racore, apo përvojën/vjetërsinë në rrjet.